

Zyra e Burimeve Njerëzore

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune të R. Maqedonisë (Gazeta Zyrtare e R. Maqedonisë nr. 62/2005), Universiteti i Evropës Juglindore – Tetovë shpall :

K O N K U R S

Për plotësimin e vendit të punës me kohë të caktuar

Përgjegjës i Zyrës së Bursarit

Qëllimi primar i pozitës: Të asistojë në funksionimin dhe administrimin e Shërbimeve Studentore duke koordinuar vlerësimin efektivë dhe grumbullimin e pagesave studentore, informim të studentëve për obligimet financiare, ruajtje të të dhënave dhe kontroll të pagesave dhe sigurim të analizave për bilancin dhe raporteve nga pagesa për menaxherët e Universitetit.

Përveç kushteve të përgjithshme të parapara me Ligji, kandidati duhet t'i plotësojë edhe kushtet që vijojnë:

Themelore:

- Diplomë universitare në administrim biznesi, lëmi të ngjashëm ose kualifikim profesional ekuivalent;
- Njohje të mirë të trendeve aktuale dhe praktikës së mirë në lëmi;
- Tre vjet përvojë punë lëmi të ngjashme si financa;

E preferueshme:

- Magjistraturë administrim biznesi, lëmi të ngjashëm ose kualifikim profesional ekuivalent;
- Përvojë pune në institucion të arsimit të lartë;
- Përvojë në koordinim të shërbimit ose një funksioni;

Kandidati duhet të posedojë shkathtësi dhe aftësi:

Themelore:

- Komunikim efektivë (gojor dhe të shkruar) në dy gjuhët lokale që përdoren në nivel të Universitetit (shqip dhe maqedonisht) dhe të kontribuon në implementimin e Politikës gjuhësore;
- Shkathtësi efektive ndër-personale dhe komunikimi, në të folur dhe shkruar;
- Aftësi për të punuar në ekip;

- Aftësi për të analizuar dhe të bëj përmbledhje të informatave;
- Aftësi për të punuar në çështje konfidenciale;
- Aftësi për të përpiluar raporte dhe dokumente të shkruara mirë;
- Aftësi për të këshilluar dhe bashkëpunuar në mënyrë efektive me studentët;
- Shkathtësi efektive organizative dhe menaxheriale;
- Aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur, fleksible dhe të bashkëpunojë;
- Aftësi që të bëj prioritetin punës në mënyrë efektive dhe që të realizoj punët brenda afatit të paraparë si dhe të punojë mirë nën presion;
- Prezencë dhe përpikëri të shkëlqyeshme dhe përdorim efektive të orarit të punës;
- Aftësi për të përdorur teknologjitë informacionit dhe sistemin kompjuterik të universitetit në mënyrë efikase për të plotësuar kërkesat e punës;
- Dëshirë për të ndjekur trajnime;
- Dëshirë për të punuar, kontribuar dhe promovuar misionin e Universitetit për përsosmëri dhe barazi;

Preferohen:

- Aftësi për komunikim efektivë (gojor dhe të shkruar) në tre gjuhët që përdoren në nivel të Universitetit (shqip, maqedonisht dhe anglisht);
- Aftësi për të identifikuar dhe iniciuar ide të reja dhe projekte dhe të vëzhgoj progresin dhe bëj përmirësime;
- Aftësi dhe dëshirë për të udhëtuar kur është e nevojshme;

Fillimi dhe përfundimi i kohës ditore dhe javore të punës: **Nga ora 08,00 deri 16,00, nga e hëna deri të premten.**

Paga bazë: **550 € (33.825 MKD)**

Afati i dorëzimit të aplikacioneve është **5 ditë** nga dita e shpalljes së konkursit.

Konkursi është i shpallur nga 12.12.2014 deri më 16.12.2014

Ju lutemi e dërgoni aplikimin për punësim nëpërmjet e-mailit: jobs@seeu.edu.mk **(Aplikacion valid do konsiderohet vetëm aplikacioni i plotësuar që gjendet në ueb faqen e Universitetit, në rubrikën Konkurse. Çdo lloj tjetër forme aplikacioni nuk do merret parasysh).**

Adresa

Universiteti i Evropës Juglindore

Zyra e Burimeve Njerëzore

Bul. "Ilinden" nr. 335

1200 Tetovë, Maqedoni

Telefoni për kontakt: 044 356 087